



Pranuar / Dorezuar Punimje/Prodato Received/Delivery	18.04.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHCIL	3652/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.464/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.464/2023 të datës 07.03.2023, të parashtruar nga ankuesi Ismail Berisha të cilin me autorizim e përfaqëson me adresë, rruga "Rexhep Luci, Nr. 45/2 në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.464/2023 e datës 07.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më datë 07.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2439/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim të shtesave në page sikurse për zyrtarët e tjerë të aviacionit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit,

Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa Këshilli, me datë 23.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2439/2023 të datës 07.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 22.09.2020; Emailin e datës 03.03.2009 nga Kosovo Civil Aviation Authority për N.B; Akt Emërimit e datës 07.07.2014 të ankuesit; CV-në e ankuesit; Diplomën me Nr. 02-2124/88-2106; Vërtetimin me Nr. 251-76-01/09-1655; Letër Referencë me Nr. 1125/11 e datës 02.02.2011; Letër Rekomandimin e datës 19.01.2011; Referencën e datës 12.11.2008; Kërkesë për zbatimin e Ligjit Nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik e datës 13.11.2019 nga ankuesi për Drejtorin e DASHC/MAP; Kërkesën e datës 07.05.2014 e parashtruar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm për kompensimin e shtesës nga fondi për kuadro; Shkrese e datës 24.08.20212 nga Drejtori i Departamentit të Aviacionit Civil; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 2755/2023 e datës 17.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2903/2023 e datës 23.03.2023; Vendimin me Nr. prot: 3085 të datës 21.04.2022 për transferim të ankuesit; Vendimin A.n.37/2022 i datës 21.02.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. prot: 5616 i datës 28.07.2020 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin e datës 17.06.2008; Vërteti i marrëdhënies së punës me Nr. port: 4181 i datës 09.09.2016; Listën e pagave për ankuesin nga viti 2008 deri në vitin 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e palejuar sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon me pretendimet ankimore për kompensim të shtesave në page sikurse për zyrtarët e tjerë të aviacionit civil dhe atë në mënyre retroaktive nga viti 2009.

Kolegji i Këshillit, bazuar në provat e lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi për pretendimet lidhur me kompensimin e shtesës në pagën bazë, nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë udhëheqësit më të lartë administrativ të institucionit si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështjeje këtë e kemi kërkuar edhe përmes kërkesës për përgjigje në ankesë mirëpo nuk është dëshmuar që para parashtrimit të kësaj ankesa të ketë parashtruar kërkesë, kështu që lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim nga udhëheqësi më i lartë administrativ në raport me të drejtën e pretenduar me ankesë, për çka ankuesi mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimit të tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 24 paragrafi 3, i cili përcakton se: “Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil...”, si dhe dispozitat e nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme



Administrative, i cili përcakton se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...".

Andaj meqenëse ankuesi në këtë procedurë administrative nuk ka parashtruar fillimisht kërkesë tek udhëheqësi më i lartë administrativ i cili konsiderohet punëdhënës i ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson që nuk janë përmbushur kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, siç parashihet me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë ankesa A.nr.464/2023 e datës 07.03.2022, e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.464/2023

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.